



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 25

2001

Maj

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr.494, datë 10.5.2001	Për emërimin e një anëtari të Komisionit të Letrave me Vlerë... 773
Vendim i Kuvendit nr. 495, datë 10.5.2001	Për emërimin e një anëtari të Komisionit të Letrave me Vlerë... 773
Vendim i Kuvendit nr. 496, datë 10.5.2001	Për emërimin e një anëtari të Komisionit të Letrave me Vlerë... 774
Vendim i Kuvendit nr.497, datë 10.5.2001	Për emërimin e dy anëtarëve të Komisionit të Letrave me Vlerë. 774
Vendim i Kuvendit nr. 498, datë 10.5.2001	Për emërimin e Kryetarit të Komisionit të Letrave me Vlerë..... 775
Aktnormativ i KM nr.2, datë 27.4.2001	Për një ndryshim në ligjin nr.8720, datë 26.12.2000 “Për krijimin e Policisë Financiare”..... 775

Aktnormativ i KM nr.3, datë 27.4.2001	Për një ndryshim në ligjin nr. 8339, datë 30.4.1998 “Për krijimin e Agjencisë së Trajtimit të Kredive”, ndryshuar me ligjin nr.8584, datë 15.3.2000.....	776
Vendim i KM nr. 83, datë 26.2.2001	Për tarifat telefonike dhe për pagesat elektrike nga personat me aftësi të kufizuar.....	776
Vendim i KM nr.292, datë 12.5.2001	Për miratimin e “Marrëveshjes shumëpalëshe për lejimin e udhëtimit të shtetasve jugosllavë, të detyruar për t’u larguar”...	777
Vendim i KM nr. 309, datë 12.5.2001	Për krijimin e Qendrës Kombëtare Arsimore të Vlerësimit dhe të Provimeve.....	783
Vendim i KM nr.338, datë 23.5.2001	Për kalimin në pronësi të një sipërfaqeje trualli, në favor të kishës katolike shqiptare, mbi të cilën do të ndërtohen kompleksi universitar “Universiteti Katolik” dhe “Qendra e Rehabilitimit dhe e Mjekësisë Sportive”.....	784
Vendim i GJK nr.29, datë 30.4.2001	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.1066, datë 1.11.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe nr.87, datë 15.7.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.....	786
Vendim i GJK nr.30, datë 2.5.2001	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.2325, datë 10.6.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës nr.1723, datë 18.12.1998 të Gjykatës së Apelit të Tiranës; nr.1121, datë 1.12.1999 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr. H-31, datë 19.12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.....	789
Vendim i GJK nr.34, datë 15.5.2001	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr.1000, datë 13.6.1997 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe nr.902, datë 23.6.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.....	792
Vendim i GJK nr.40, datë 17.5.2001	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të ligjit nr.8746, datë 28.2.2001 “Për përcaktimin e zonave zgjedhore”.....	794
Vendim i GJK nr.41, datë 17.5.2001	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.70, datë 12.2.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr.1348, datë 1.11.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë...	798

V E N D I M
Nr.494, datë 10.5.2001

PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË KOMISIONIT
TË LETRAVE ME VLERË

Në mbështetje të nenit 2 pika 3 të ligjit nr.8745, datë 22.2.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë”, ndryshuar me ligjin nr.8186, datë 5.12.1996” dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Dhomës së Tregtisë dhe të Industrisë,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

- I. Zoti Adrian Fullani emërohet në detyrën e anëtarit të Komisionit të Letrave me Vlerë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.495, datë 10.5.2001

PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË KOMISIONIT
TË LETRAVE ME VLERË

Në mbështetje të nenit 2 pika 3 të ligjit nr.8745, datë 22.2.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë”, ndryshuar me ligjin nr.8186, datë 5.12.1996” dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

- I. Zoti Marjan Gjermani emërohet në detyrën e anëtarit të Komisionit të Letrave me Vlerë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.496, datë 10.5.2001

**PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË KOMISIONIT
TË LETRAVE ME VLERË**

Në mbështetje të nenit 2 pika 3 të ligjit nr.8745, datë 22.2.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë”, ndryshuar me ligjin nr.8186, datë 5.12.1996” dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

- I. Zoti Fatos Reça emërohet në detyrën e anëtarit të Komisionit të Letrave me Vlerë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.497, datë 10.5.2001

**PËR EMËRIMIN E DY ANËTARËVE TË KOMISIONIT
TË LETRAVE ME VLERË**

Në mbështetje të nenit 2 pika 3 të ligjit nr.8745, datë 22.2.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë”, ndryshuar me ligjin nr.8186, datë 5.12.1996” dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

- I. Zonja Elisabeta Gjoni dhe zonja Rexhina Nano emërohen në detyrën e anëtarit të Komisionit të Letrave me Vlerë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.498, datë 10.5.2001

**PËR EMËRIMIN E KRYETARIT TË KOMISIONIT
TË LETRAVE ME VLERË**

Në mbështetje të nenit 5 ligjit nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë”, ndryshuar me ligjin nr.8186, datë 5.12.1996 dhe ligjin nr.8745, datë 22.2.2001 dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Presidentit të Republikës,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

I. Miratohet propozimi i Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Fatos Reça në detyrën e Kryetarit të Komisionit të Letrave me Vlerë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

A K T N O R M A T I V Nr.2, datë 27.4.2001

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8720, DATË 26.12.2000 “PËR KRIJIMIN E POLICISË FINANCIARE”

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr.8720, datë 26.12.2000, neni 15 ndryshon si më poshtë vijon:
“Veprimtaria e Policisë Financiare fillon më 1 janar 2002.”

Neni 2

Ky aktnormativ hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Miratuar me ligjin nr.8796, datë 14.5.2001 të Kuvendit, të shpallur me dekretin nr.3031, datë 24.5.2001 të Presidentit të Republikës Rexhep Meidani

A K T N O R M A T I V Nr.3, datë 27.4.2001

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8339, DATË 30.4.1998 “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË KREDIVE”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8584, DATË 15.3.2000

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

NENI 1

Në ligjin nr.8339, datë 30.4.1998, fjalia e fundit e nenit 2 ndryshon si më poshtë vijon:
“Afati i veprimtarisë së Agjencisë së Trajtimit të Kredive mbaron në datën 31.12.2001.”

Neni 2

Ky aktnormativ hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Miratuar me ligjin nr.8797, datë 14.5.2001 të Kuvendit, të shpallur me dekretin nr. 3032, datë 24.5.2001 të Presidentit të Republikës Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr.83, datë 26.2.2001

**PER TARIFAT TELEFONIKE DHE PËR PAGESAT ELEKTRIKE NGA PERSONAT
ME AFTËSI TË KUFIZUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të nenit 12 të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit”, si dhe të nenit 38 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Çdo përdorues me aftësi të kufizuar ku përfshihet:

a) invalidi paraplegjik dhe tetraplegjik;

b) i verbëri i paaftë për të lëvizur pa shoqërues, në kushte fizike të invaliditetit të grupit të

parë, përfiton 700 impulse në muaj me tarifa telefonike të nivelit të parë, të favorizuar për popullsinë.

2. Këto impulse çlirohen nga tatimi dhe nga çdo ngarkesë tjetër.

Diferenca do t'i paguhet “Albtelekom”-it nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Çdo përdorues me aftësi të kufizuar, sipas pikës 1, paguan 20 për qind të vlerës së konsumit mujor të energjisë elektrike.

Diferencat do t'i paguhet KESH-it nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Shëndetësisë të nxjerrin një udhëzim të përbashkët për modalitetet e marrëdhënieve mes përfituesve dhe institucioneve ofruese.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 292, datë 12.5.2001

**PËR MIRATIMIN E “MARRËVESHJES SHUMËPALËSHE PËR LEJIMIN E UDHËTIMIT
TË SHTETASVE JUGOSLLAVË, TË DETYRUAR PËR T’U LARGUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e marrëveshjes shumëpalëshe për lejimin e udhëtimit të shtetasve jugosllavë, të detyruar për t’u larguar.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

MARRËVESHJE
**MBI LEJIMIN E UDHËTIMIT TRANSIT TË SHTETASVE JUGOSLLAVË, TË DETYRUAR
PËR T’U LARGUAR**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave të Bosnjës dhe të Hercegovinës, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, Qeveria e Republikës Italiane, Qeveria e Republikës së Kroacisë, Qeveria Federale Austriake, Këshilli Federal Zviceran, Qeveria e Republikës së Sllovenisë, Qeveria e Republikës së Hungarisë.

Ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Udhëtim Transit me qëllim kthimi

1. Palët kontraktuese ua lejojnë shtetasve jugosllavë me qëndrim në territorin e një prej palëve kontraktuese, të cilët nuk plotësojnë kushtet në fuqi për qëndrim të mëtejshëm atje, udhëtimin vullnetar vetëm me një të drejtë kalimi transit nëpër territorin e tyre me qëllimin e kthimit. Kjo nuk vlen për ato raste kur personit në fjalë i është ndaluar hyrja në një nga shtetet transit.

2. Kusht për udhëtimin transit është zotërimi i një pasaporte të vlefshme sipas ligjit jugosllav në fuqi për pasaportat ose e një dokumenti të Republikës Federale të Jugosllavisë, i cili zëvendëson pasaportën. Për kthimin nga një shtet nisjeje nëpër territorin e një pale kontraktuese për në Kosovë mund të lëshohet për udhëtimin e kthimit në rast nevoje ose një dokument kombëtar i palëve kontraktuese, i cili zëvendëson pasaportën (fletëkalimi i Bashkimit Europian). Mostrat e dokumenteve kombëtare dhe ndërkombëtare të përmendura, të cilat zëvendësojnë pasaportën, i bashkëngjiten kësaj marrëveshjeje si shtojcë 1. Verifikimi i vlefshmërisë së dokumenteve të ndryshme për udhëtimin e kthimit bëhet nga shteti i nisjes. Dokumenti i udhëtimit përmban një shënim (vinjetë) me një afat vlefshmërie tremujore, në të cilin shënohet se mbajtësi po kthehet në Jugosllavi. Mostrat e këtij shënimi (vinjete) i bashkëngjiten kësaj marrëveshjeje si shtojcë 2.

3. Shteti i nisjes merr përsipër detyrimin ta ripranojë atë person, për të cilin nuk janë të garantuara udhëtimi i mëtejshëm vullnetar transit nëpër shtetet eventuale ose hyrja në shtetin e destinacionit. Në këtë rast, shtetet transit lejojnë edhe një udhëtim tjetër transit. Në rast nevoje, autoritetet kompetente të shtetit përkatës transit mund të lëshojnë një dokument zëvendësues udhëtimi për kthimin e personit në fjalë për në shtetin e nisjes. Mostrat e këtyre dokumenteve zëvendësuese të udhëtimit i bashkëngjiten kësaj marrëveshjeje si shtojcë 3.

4. Palët kontraktuese duhet të tregojnë kujdes që udhëtimi transit i shtetasve jugosllavë të kryhet sa të jetë e mundur në rrugë të drejtëpërdrejtë. Autoritetet kompetente të shtetit të nisjes i shënojnë shtetet e parashikuara për udhëtim transit në dokumentin e udhëtimit të personit në fjalë.5. Një vizë transiti e palëve kontraktuese nuk është e nevojshme.

6. Dispozitat ligjore doganore të palëve kontraktuese mbeten të paprekura.

7. Shtetet transit mund të mbajnë shënime mbi të dhënat personale (mbiemri, emri, datëlindja, vendlindja, lloji dhe numri i dokumenteve të udhëtimit), si dhe mbi vendin dhe kohën e hyrjes dhe të daljes së personave në fjalë.

Neni 2 **Ripranimi**

1. Për të plotësuar detyrimin e tyre lidhur me ripranimin sipas nenit 1 paragrafi 3, shtetet e nisjes bëjnë regjistrimin e të dhënave personale (mbiemri, emri, datëlindja, vendlindja), e llojit dhe numrit të dokumenteve të udhëtimit të përmendura në nenin 1 paragrafi 2, si dhe të dhënave të tjera që do të nevojiteshin për identifikim në rastin e humbjes së dokumenteve të udhëtimit (p.sh. fotokopje të dokumentit të udhëtimit përfshirë edhe fotografinë).

2. Shpenzimet që do t'i dalin një pale kontraktuese, lidhur me ripranimin sipas nenit paragrafi 3 për transport, shoqërimin e nevojshëm, strehim, ushqim etj., merren përsipër nga shteti i nisjes. Shlyerja e shpenzimeve bëhet brenda 60 ditësh pas marrjes së faturës.

Neni 3 **Klauzola për mbrojtjen e të dhënave**

Për aq kohë sa për zbatimin e kësaj marrëveshjeje bëhet regjistrimi ose këmbimi i të dhënave personale, këto informacione duhet t'u referohen vetëm:

të dhënave vetiake të personave që kryejnë udhëtimin transit (mbiemri, emri, në rastet përkatëse mbiemri i mëparshëm, emrat shtesë ose pseudonimet, datëlindja, vendlindja, seksi, shtetësia aktuale dhe e mëparshme),

të dhënave mbi dokumentet e udhëtimit (lloji, numri, afati i vlefshmërisë, data e lëshimit, autoriteti lëshues, vendi i lëshimit etj.),

të dhënave të tjera të nevojshme për identifikimin e personit në fjalë, me kërkesë të një pale kontraktuese.

Përderisa mbi bazën e kësaj marrëveshjeje dhe duke u mbështetur në legjislacionin e brendshëm të shtetit këmbehen të dhëna personale, janë të vlefshme si plotësim rregullat e mëposhtme, duke respektuar dispozitat ligjore që vlejnë për secilën palë kontraktuese:

Përdorimi i të dhënave nga marrësi lejohet vetëm për qëllimin e shënuar dhe vetëm me kushtet e caktuara nga autoriteti që jep të dhënat.

Marrësi e informon autoritetin që jep të dhënat, me kërkesë të këtij të fundit, për përdorimin e të dhënave të transmetuara dhe për rezultatet e arritura përmes tyre.

Të dhëna personale mund t'u komunikohen vetëm autoriteteve kompetente. Transmetimi i mëtejshëm i tyre për në institucione të tjera mund të bëhet vetëm me miratim paraprak të autoritetit që ka dërguar të dhënat.

Autoriteti që jep të dhënat mban përgjegjësi për korrektësinë e të dhënave të komunikuar, si dhe është i detyruar të respektojë domosdoshmërinë dhe përshtatshmërinë lidhur me qëllimin e komunikimit, duke mbajtur parasysh dispozitat e legjislacionit brendashtetëror të secilit vend, në lidhje me ndalimin e komunikimit të të dhënave. Nëse vërtetohet se janë dhënë më tej të dhëna të gabuara ose të dhëna që nuk duheshin komunikuar, atëherë një gjë e tillë i duhet bërë e ditur menjëherë marrësit. Ai është i detyruar të bëjë korrigjimin ose asgjësimin e të dhënave në fjalë.

Autoriteti që jep të dhënat dhe autoriteti marrës janë të detyruar të dokumentojnë në dosjen e tyre transmetimin dhe marrjen e të dhënave personale.

Autoriteti që jep të dhënat dhe autoriteti marrës janë të detyruar t'i mbrojnë të dhënat personale të transmetuara në mënyrë të efektshme kundër përdorimit të paautorizuar, ndryshimit të

paautorizuar dhe shpalljes së paautorizuar.

Personi në fjalë duhet të informohet - me kërkesë të tij - për të dhënat personale të transmetuara, si dhe për ç'qëllim parashikohet të përdoren ato. Detyrimi për dhënie informacioni nuk ekziston, për sa kohë që nga vlerësimi përkatës del se interesi publik, që informacioni të mos jepet, është më i rëndësishëm sesa interesi i personit në fjalë që ta marrë këtë informacion. Përveç kësaj, e drejta e personit në fjalë për t'u informuar mbi të dhënat ekzistuese mbi personin e tij, i nënshtrohet së drejtës brendashtetërore të asaj pale kontraktuese, në territorin e së cilës kërkohet informacioni.

Përderisa e drejta kombëtare në fuqi për autoritetin komunikues parashikon afate të caktuara për asgjësimin e të dhënave personale të transmetuara, autoriteti që ka dhënë të dhënat e njofton marrësin për këtë. Pavarësisht nga këto afate, të dhënat e komunikuar personale duhet të asgjësohen sapo të mos nevojiten më për qëllimin për të cilin janë transmetuar.

Neni 4 Autoritetet kompetente

1. Autoritetet kompetente ku bëhen kërkesat për informacion, për shqyrtimin dhe për zbatimin e riprimit, sipas nenit 1 paragrafi 3 dhe nenit 3, janë:

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë:

Ministria e Rendit Publik

Drejtoria e Policisë Kufitare

Sheshi Skënderbej 3

Tiranë

Telefon: + 355 42 28098 (qendra operative)

+ 355 42 26801 (centrali)

Fax: + 355 42 63607

Për Këshillin e Ministrave të Bosnjës dhe të Hercegovinës:

Ministria e Çështjeve Civile dhe Komunikacionit

Spektori i Refugjatëve

Ulica Musala Br.9

Sarajevo, 71 000

Tel/fax: + 387 71442 870 dhe 650 068

Për Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë:

Grenzschutzdirektion (Drejtoria e Mbrojtjes Kufitare)

Roonstrasse 13

D-56068 Koblenz

Telefon: + 49261/399-0 (centrali = Vermittlung)

Fax: + 49261/399-218

Për Qeverinë e Republikës Italiane:

Ministria e Punëve të Brendshme

Dega e Policisë Rrugore

Drejtoria e Përgjithshme për Policinë Rrugore,

Hekurudhat, Kufijtë dhe Postën

Nëndega e Imigracionit dhe Policisë Kufitare

Via Cavour 6

I-00184 Roma

Telefon: + 39 06 46539625 ose +39 06 465 39669

Fax: + 39 06 465 39993 ose + 39 06 465 39994

Për Qeverinë e Republikës së Kroacisë:

Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kroacisë

Spektori i Policisë së Rendit

Dega e Policisë Kufitare

Savska cesta 39

HR-10000 Zagreb
Telefon: + 385 161 22479
Fax: + 385 161 22 836
Për Qeverinë Federale Austriake:
Ministria Federale e Punëve të Brendshme
Drejtoria III/16
Am Hof 4
A-1014 Wien

Telefon: + 431/53126 aparati = Nebenstelle: 4621
Fax: + 431/53126 aparati = Nebenstelle: 4648
Për Këshillin Federal Zviceran:
Departamenti i Drejtësisë dhe i Policisë i Konfederatës Zvicerane
Zyra Federale për Refugajtët
Quellestrasse 6

CH- 3003 Bern-Wabern
Telefon: + 41/31 325 9414
Fax: + 41/31 325 9115
Për Qeverinë e Republikës së Sllovenisë:
Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Sllovenisë:
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
Sektori për kufirin shtetëror dhe shtetasit e huaj
Stefanova 2

SL-1501 Ljubljana
Telefon: + 38661 217 580
Fax: 386 61 217 450

Për Qeverinë e Republikës së Hungarisë:
Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Hungarisë:
Zyra e Imigrimit dhe e Shtetësisë
Budafoki ut 60

Pf.:314
H- 1903 Budapest
Telefon: + 36 1 463 9152
Fax: + 36 1 463 9153

Autoritetet kompetente u përgjigjen kërkesave për informacion brenda kufirit të kësaj marrëveshjeje pa vonesë, jo më vonë se brenda dy javësh pas marrjes së kërkesës.

Neni 5

Detyrimi për konsultime

Palët kontraktuese detyrohen që problemet që lindin gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje t'i zgjidhin në frymën e mirëkuptimit dhe të shkëmbejnë të gjitha informacionet e nevojshme për këtë qëllim. Secila palë kontraktuese mund të bëjë, sipas nevojës, menjëherë ftesë për të zhvilluar bisedime për zgjidhjen e problemeve aktuale, gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Neni 6

Përparësia e marrëveshjeve ndërshtetërore

Detyrimet e palëve kontraktuese që rrjedhin nga marrëveshjet ndërshtetërore mbeten të paprekura.

Neni 7

Afati i vlefshmërisë, hyrja në fuqi, depozituesi

Kjo marrëveshje lidhet për një afat të papërcaktuar.

Për ato palë kontraktuese të cilat e kanë nënshkruar këtë marrëveshje dhe nuk duhet të plotësojnë kushte të tjera paraprake brendashtetërore, kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e tridhjetë pas nënshkrimit të saj.

Për ato palë kontraktuese, që duhet të plotësojnë kushte të tjera paraprake brendashtetërore, kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas ditës, në të cilën pala e fundit kontraktuese e ka njoftuar me anë të një note depozituesin, sipas paragrafit 5 të këtij neni, që, nga ana e saj, janë të plotësuar kushtet e nevojshme paraprake brendashtetërore.

Palët kontraktuese, sipas paragrafit 3, e zbatojnë këtë marrëveshje përkohësisht, duke filluar me ditën e tridhjetë pas nënshkrimit të saj, sipas deklaratës së tyre të bashkëngjitur. Deklarata në cilësinë e shtojcës është pjesë e pandarë e kësaj marrëveshjeje.

Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë është depozitues i kësaj marrëveshjeje.

Neni 8

Aderimi i shteteve të tjera

Palët kontraktuese bien dakort se në këtë marrëveshje mund të aderojnë edhe shtete të tjera.

Pas marrjes së njoftimit, lidhur me kërkesën për aderim, depozituesi i njofton menjëherë në rrugë diplomatike palët e tjera kontraktuese. Palët kontraktuese shprehin mendimin e tyre për kërkesën e aderimit, brenda 30 ditësh pas marrjes së njoftimit përkatës prej depozituesit.

Për shtetin aderues, marrëveshja hyn në fuqi 30 ditë pas marrjes nga depozituesi të miratimit të fundit të palëve të tjera kontraktuese për hyrjen në fuqi.

Neni 9

Pezullimi, shfuqizimi

Secila palë kontraktuese mund ta pezullojë ose ta shfuqizojë këtë marrëveshje me anë të një note që i drejtohet ruajtësit, kur ka një arsye të fortë, në mënyrë të veçantë në rastin e prishjes ose të rrezikimit të sigurisë dhe të shëndetit publik, pas konsultimit me palët e tjera kontraktuese.

Pezullimi hyn në fuqi një ditë pas marrjes së notës për pezullimin, shfuqizimi hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas marrjes së notës për shfuqizimin nga depozituesi.

Lidhur në Berlin më datë 21 mars 2000 në një tekst original në gjuhën shqipe, boshnjake, gjermane, italiane, kroate, serbe, sllovene dhe hungareze, duke patur secili tekst vlerë detyruese të barabartë.

SHTOJCË DEKLARATË

Sipas nenit 7 paragrafi 4 të Marrëveshjes mbi lejimin e udhëtimit transit të shtetasve jugosllavë që janë të detyruar të largohen,

Qeveritë e Shqipërisë, të Bosnjës dhe të Hercegovinës, të Kroacisë, të Sllovenisë dhe të Hungarisë deklarojnë se ata do të zbatojnë këtë marrëveshje përkohësisht deri në plotësimin e kushteve brenda shtetërore paraprake të nevojshme.

V E N D I M
Nr. 309, datë 12.5.2001

**PËR KRIJIMIN E QENDRËS KOMBËTARE ARSIMORE TË VLERËSIMIT
DHE TË PROVIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare Arsimore të Vlerësimit dhe të Provimeve në Republikën e Shqipërisë. Kjo qendër është institucion publik, i veçantë, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

2. Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe e Provimeve vepron si një njësi teknike, profesionale dhe mbështetëse për punonjësit e arsimit dhe ka për mision:

2.1 Hartimin dhe administrimin e testeve, si dhe të instrumenteve të tjera të vlerësimit të të nxënit.

2.2 Përpunimin dhe kryerjen e analizave statistikore e psikometrike të të dhënave të siguruar nga testimet kombëtare dhe nga provimet, me qëllim përmirësimin e tyre.

2.3 Monitorimin e progresit të nxënësve, informimin dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

2.4 Mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore për zhvillimin e sistemit arsimor në tërësi dhe paraqitjen e të dhënave, të rezultateve e të rekomandimeve përkatëse Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

2.5 Kualifikimin e mësuesve, të anëtarëve të rrjetit, si dhe specialistëve të arsimit për vlerësimet e provimeve kombëtare.

2.6 Botimin e raporteve për rezultatet e vlerësimeve dhe të provimeve kombëtare, si dhe të materialeve të tjera të fushës së vlerësimit arsimor.

3. Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe e Provimeve, për kryerjen e misionit të saj, mbështetet në funksionimin e rrjetit të bashkëpunëtorëve qendrorë dhe vendorë.

4. Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe e Provimeve merr detyra, që përputhen me misionin e saj, nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Ajo gëzon pavarësi profesionale në kryerjen e misionit dhe të detyrave të saj.

5. Struktura dhe organika e Qendrës Kombëtare Arsimore të vlerësimit dhe të provimeve përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Drejtori i kësaj Qendre emërohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të Qendrës rregullohen me Kodin e Punës së Republikës të Shqipërisë.

6. Qendra harton dhe dërgon për miratim në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës statusin dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të saj, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

7. Trajtimi financiar i Drejtorit të Qendrës Kombëtare Arsimore të Vlerësimit dhe të Provimeve do të barazohet me klasën B2 të lidhjes nr.1 “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit”, ndërsa specialistët do të barazohen me klasën C2 të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore” të Këshillit të Ministrave.

8. Efektet financiare dhe rritja e numrit të punonjësve që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2001 për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe numri i punonjësve të miratuar për këtë institucion.

9. Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe e Provimeve do të financohet nga Buxheti i Shtetit deri në vitin 2005. Pas vitit 2005 Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe e Provimeve do të vetëfinancohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.338, datë 23.5.2001

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI, NË FAVOR TË KISHËS
KATOLIKE SHQIPTARE, MBI TË CILËN DO TË NDËRTOHEN KOMPLEKSI
UNIVERSITAR “UNIVERSITETI KATOLIK” DHE “QENDRA E REHABILITIMIT
DHE E MJEKËSISË SPORTIVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 dhe 4 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave


V E N D O S I:

1. Kalimin në pronësi të Kishës Katolike Shqiptare të një sipërfaqeje trualli prej 49 453 m², sipas genplanit që i bashkëlidhet këtij vendimi, mbi të cilën do të ndërtohen kompleksi universitar “Universiteti Katolik” dhe “Qendra e Rehabilitimit dhe e Mjekësisë Sportive”.
2. Koeficienti i përlllogaritjes së çmimit të shitjes së truallit të jetë 0.001.
3. Ngarkohet Bashkia e Tiranës për nënshkrimin e kontratës së shitblerjes së këtij trualli.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

E = 39940000

Planvendosja e “Universitetit katolik” dhe “Qendrës së rehabilitimit dhe mjekësisë sportive”
Shk. 1 : 2000



Nr.License T0041/3
TIRANE 25 Prill 2001

V E N D I M
Nr.29, datë 30.4.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Hajredin Fuga	Anëtar i	““
Alfred Karamuço	Anëtar i	““
Kujtim Puto,	Anëtar i	““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	““
Zija Vuci,	Anëtar i	““

me sekretare Arbenka Lalica, më datën 9.3.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.10 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: Ardian Kalia, i përfaqësuar nga avokat Fatmir Tartale.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Këshilli i Lartë i Drejtësisë, i përfaqësuar nga inspektori Adnand Kosova, me akt përfaqësimi.

O B J E K T I:

Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.1066, datë 1.11.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe nr.87, datë 15.7.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Për shfuqizimin si antikushtetues të këtyre vendimeve kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

Ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor që konsiston në këto drejtime:

- Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka marrë vendim për shkarkimin e tij nga detyra si gjyqtar, duke marrë pjesë si anëtar edhe zoti Pajtim Hoxha, ndonëse ky ka qenë kryesues i trupit gjykues në një çështje penale të gjykuar nga kërkuesi, për të cilën është diskutuar në mbledhjen e këtij organi se është dhënë dënim i butë dhe se për këtë është ngarkuar vetëm ai me përgjegjësi.

- Këshilli i Lartë i Drejtësisë, duke tejkuluar kompetencat e veta, ka dhënë kundër tij një masë disiplinore më të rëndë nga ajo që ka propozuar Ministri i Drejtësisë.

Nga ana tjetër, për këtë masë ekstreme që ai ka zbatuar, kërkuesi nuk është vënë në dijeni qysh më parë për mundësinë e zbatimit të saj, kështu që është privuar nga e drejta për të organizuar një mbrojtje të përshtatshme.

- Në kundërshtim me çdo parim, është ndëshkuar kryesisht për gjykime të padrejta edhe në ato çështje, vendimet e të cilave, në kohën kur është bërë kontrolli nga Inspektoriati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kishin marrë formë të prerë.

- Nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimi për lënien në fuqi të kësaj mase disiplinore të zbatuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, është shpallur i paarsyetuar. Arsyetimi i tij pas 1 (një) muaji, vjen në kundërshtim me nenin 142 pika 1 të Kushtetutës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin zotin Zija Vuci, kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, përfaqësuesin e subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi Ardian Kalia, me vendim nr.87, datë 15.7.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është shkarkuar nga detyra si gjyqtar i shkallës së parë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me motivacionin e “kryerjes së veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës”, vendim ky që është lënë në fuqi me vendimin nr.1066, datë 01.11.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Gjykata Kushtetuese, duke analizuar shkaqet për të cilat ai ka kërkuar shfuqizimin e këtyre vendimeve, konstaton se vetëm njëri nga këto shkaqe meriton të merret në konsideratë, sepse është i mjaftueshëm për pranimin e kërkesës.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, vendimin e tij për shkarkimin nga detyra të kërkuesit, e ka mbështetur në vlerësimet negative që i ka bërë grupi i inspektorëve vetëm gjashtë vendimeve gjyqësore të dhëna nga kërkuesi, ose si gjyqtar i vetëm, ose si anëtar i trupit gjykues me gjyqtarë të tjerë. Del se nga këto vendime, katër prej tyre kanë marrë formën e prerë, tre që nuk janë ankimuar dhe një tjetër që është lënë në fuqi nga instancat gjyqësore më të larta; ndërsa dy vendime të tjerë janë ndryshuar nga Gjykata e Apelit, por vetëm për masën dhe jo për llojin e dënimit.

Në përgjithësi, vërejtjet për këto vendime nuk kanë të bëjnë me shkelje të karakterit procedural, por vetëm me zbatim të gabuar të ligjit material, i cili sipas konkluzioneve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është reflektuar kryesisht, në caktimin e masave të buta të dënimit me burgim, në një rast në cilësimin ligjor jo të drejtë të veprës penale; ndërsa në një rast tjetër, në zgjidhjen e gabuar të një çështjeje civile. Del se evidentimi i këtyre shkeljeve është realizuar jo në rrugën e verifikimit të ankesave të shtetasve, siç parashikon neni 17 i ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, por nëpërmjet kontrollit të përgjithshëm që ka ushtruar Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mbi veprimtarinë njëvjeçare të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe këto janë konsideruar si shkelje të disiplinës në punë të kryera në formën e veprimeve që vijnë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës nga ana e kërkuesit.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, duke i hyrë vlerësimin të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë të këtyre vendimeve gjyqësore të dhëna nga kërkuesi në një kohë që këto kishin marrë formë të prerë, ka vepruar në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 135 pika 1 të Kushtetutës.

Kjo dispozitë, e cila bën dallimin midis gjyqtarëve sipas funksioneve, ka për qëllim t'i shkëpusë ata nga varësia hierarkike dhe t'ia nënshtrojë veprimtarinë e tyre në dhënien e drejtësisë, vetëm kontrollit të instancave më të larta gjyqësore, sipas rregullave të përcaktuara në Kodet e Procedurave.

Vendimet gjyqësore të formës së prerë, për çështjen konkrete që zgjidhin, kanë fuqinë e ligjit. Kjo do të thotë se përse kohë ato nuk janë prishur ose ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër shtetëror nuk mund të mos përfillë përmbajtjen e tyre dhe të ngarkojë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes.

Megjithatë, problemi ndryshon në rastet kur këto vendime janë shoqëruar me shkelje që diskreditojnë rëndë pozitën ose figurën e gjyqtarit dhe që cenojnë në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor.

Në raste të tilla, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ka kompetenca të plota të marrë çdo lloj mase disiplinore ndaj gjyqtarëve, pa e kondicionuar atë, me faktin nëse kjo kategori vendimesh kanë marrë formë të prerë dhe kanë fituar kështu autoritetin e gjësë së gjykuar. Madje, ndaj akteve të kësaj natyre të kryera gjatë ushtrimit të detyrës, ai mund të reagojë në çdo kohë edhe kur nuk ka përfunduar shqyrtimi i çështjes.

Por, në përzgjedhjen e masës disiplinore të zbatuar ndaj kërkuesit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nuk ka pasur sa duhet parasysh edhe kërkesat e nenit 147 pika 6 të Kushtetutës.

Sipas kësaj dispozite, shkarkimi nga detyra i gjyqtarit vendoset vetëm në raste të caktuara, midis të tjerash edhe për shkelje të ndryshme të disiplinës në punë, të kryera këto në ndonjë nga format e parashikuara në ligjin nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”.

Megjithatë, jo çdo shkelje, qoftë kjo e kryer edhe në formën e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, përlij marrjen e kësaj mase ekstreme.

Zbatimi i saj, në vështrim të dispozitës kushtetuese të lartpërmendur, është e lidhur vetëm me kryerjen e akteve që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit.

Gjykata Kushtetuese, duke iu referuar çështjes në shqyrtim, konstaton se Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ashtu si edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk kanë argumentuar se cilat janë shkaqet e vërteta të shkeljeve që i atribuohen kërkuesit. Me fjalë të tjera, ata nuk janë shprehur nëse këto mangësi në punën e kërkuesit janë rezultat i veprimeve me dashje që diskreditojnë pozitën e tij si gjyqtar apo janë gabime të zakonshme që mund të kenë ardhur nga mungesa e përvojës së tij në këtë detyrë.

Sqarimi i këtyre rrethanave, në këtë rast, ishte i domosdoshëm për shkak se kërkuesi është ngarkuar me përgjegjësi, kryesisht për dhënien e dënimeve të buta ose për zbatim të gabuar të ligjit material në çështje që pjesa më e madhe e tyre kanë përfunduar me vendime të formës së prerë, pasi nuk dihet me siguri nëse këto shkelje do të vlerësoheshin të tilla edhe nga instancat gjyqësore më të larta, në rast se këto vendime do t'i nënshtroheshin kontrollit të tyre të zakonshëm gjyqësor.

Në këto rrethana, përveç vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duhet të shfuqizohet edhe vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me të cilin është përligjur rezultati i këtij procesi të parregullt disiplinor të zhvilluar kundër kërkuesit.

Përsa i përket argumenteve të tjera të paraqitura nga kërkuesi, Gjykata Kushtetuese çmon se ato nuk kanë ndikuar në dhënien e këtyre vendimeve dhe për këtë shkak nuk i merr për bazë.

Kështu, pjesëmarrja në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë e një anëtari të tij, për të cilin kërkuesi ka shprehur rezerva ose dyshime për njëanshmëri, në fakt nuk i ka ndryshuar dhe as ka patur mundësi t'i ndryshonte rrjedhën këtij procesi disiplinor, duke e drejtuar atë kundër ose në favor të tij. Kjo për arsye se nga provat shkresore del që të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë kanë votuar për shkarkimin nga detyra të kërkuesit, me përjashtim të kryetarit dhe të një anëtari tjetër të këtij organi, të cilët kanë abstenuar.

E së njëjtës natyrë është edhe shkelja tjetër e pretenduar nga kërkuesi në lidhje me arsyetimin e vendimit nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pas një muaji nga data e shpalljes. Edhe kjo shkelje nuk ka ndikuar në zgjidhjen e çështjes, përderisa është kryer pas shpalljes së asaj që është vendosur, aq më tepër që kërkuesi nuk ka ngritur ndonjë pretendim për ekzistencën e ndonjë kundërthënie midis asaj që është shpallur dhe përmbajtjes së këtij vendimi.

I pabazuar, në dallim nga dy pretendimet e sipërme të kërkuesit, është ai që ka lidhje me ashpërsimin e masës disiplinore të zbatuar ndaj tij nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, e krahasuar kjo me atë të propozuar nga Ministri i Drejtësisë.

Në përzgjedhjen e këtyre masave, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka kompetenca të plota dhe nuk është aspak i lidhur me ato të propozuara nga Ministri i Drejtësisë.

Po ashtu, i pambështetur është edhe pretendimi tjetër i kërkuesit se nuk i janë krijuar kushtet për të organizuar si duhet mbrojtjen e tij, për shkak se nuk i është komunikuar në kohë edhe mundësia e marrjes ndaj tij të masës së shkarkimit nga detyra.

Përkundrazi, nga materiali i çështjes del se për të gjitha shkeljet që i janë atribuar dhe që është gjykuar, ai është njoftuar rregullisht 10 ditë përpara se të mblidhej Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Kjo kohë ka qenë për të mëse e mjaftueshme dhe ai s'ka pasur asnjë lloj pengese që të ndërtonte një mbrojtje të përshtatshme ndaj çdo mase disiplinore që eventualisht mund të zbatohet kundër tij.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.1066, datë 1.11.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe nr.87, datë 15.7.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr. 30, datë 2.5.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapi,	Anëtar i ““
Zija Vuci,	Anëtar i ““
Hajredin Fuga,	Anëtar i ““
Kristofor Peçi,	Anëtar i ““
Sokol Sadushi,	Anëtar i ““
Alfred Karamuço,	Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 13.3.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.16 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: Hajredin Fratari, i përfaqësuar nga avokatët Përparim Sanxhaku e Agim Shkupi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Vlash Marini, i përfaqësuar nga avokat Gjergj Sauli.

Nefink, në mungesë.

Agjencia Kombëtare e Privatizimit, e përfaqësuar nga juristja Diana Lamaj.

Ministria e Punëve Publike dhe e Privatizimit, në mungesë.

O B J E K T I:

Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.2325, datë 10.6.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.1723, datë 18.12.1998 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.1121, datë 1.12.1999 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr. H-31, datë 19.12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Në shqyrtimin e çështjes gjyqësore me palë: paditës Vlash Marini e i paditur kërkuesi, me objekt pavlefshmëri të kontratave të shitjes nëpërmjet ankandit të objektit për prodhim dyer-dritare plastike, kërkuesi pretendon se gjykatat kanë zhvilluar një proces të parregullt duke paraqitur këto shkaqe:

- Kanë pranuar si paditës Vlash Marinin, i cili nuk legjitimohej, në kuptim të nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile.

- Në vendimet e tyre për pavlefshmërinë e kontratave, gjykatat kanë tejkaluar objektin e padisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin Alfred Karamuço, shpjegimet e përfaqësuesve të kërkuesit dhe të subjekteve të interesuara si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.2325, datë 10.6.1998 ka vendosur të vërtetojë pavlefshmërinë absolute të kontratave të shitjes të objektit në proces për prodhim dyer-dritare si dhe të truallit të zënë nga objekti i mësipërm, lidhur midis blerësit me ankand, Hajredin Fratari dhe shitës Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe NEFINK – Tiranë. Njëkohësisht, gjykata ka vendosur detyrimin e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit t'i kthejë të paditurit Hajredin Fratari vlerën e paguar në blerje, kurse ky i fundit t'i kthejë paditësit Vlash Marini dhe NEFINK-ut,

objektin si dhe truallin. Ky vendim është lënë në fuqi nga gjykata e apelit dhe nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Kolegji Seleksionues i Gjykatës së Lartë ka refuzuar të kalojë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara një rekurs të paraqitur nga Hajredin Fratari, me arsyetimin se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenet 472 e 473 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Kushtetuese ka arritur në përfundimin se vendimet gjyqësore për të cilat kërkuesi ka pretendime për antikushtetutshmëri, nuk janë rezultat i ndonjë procesi të parregullt, në kuptimin kushtetues.

Në bazë të nenit 42 pika 2 e Kushtetutës, kushdo ka të drejtën e një gjykimi për të mbrojtur të drejtat, liritë dhe interesat e tij kushtetuese e ligjore. Po kështu, në bazë të nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile, kur personi ka një interes të ligjshëm në njohjen ose rrëzimin e një pretendimi, ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë. Nisur nga kuptimi i këtyre dispozitave, si dhe nga të gjitha materialet që ndodhen në dosjen gjyqësore, Gjykata Kushtetuese ka arritur në konkluzion se Vlash Marini legjitimohej të ngrinte padi për pavlefshmëri të kontratave të shitjes së objektit e të truallit.

Legjitimimi për rastin në shqyrtim lidhet me faktin se Vlash Marini ka hyrë në një marrëveshje, ka realizuar disa detyrime që rridhnin nga ajo (kontraktimin e blerjes së makinerive), ka bërë shpenzime efektive (në pagesën e një pjese të makinerive) etj. Në këtë kuptim, nuk mund të pranohet që Vlash Marini nuk ka pasur interes, e për rrjedhojë nuk legjitimohej të ngrinte padi. Në kërkesën e tij, kërkuesi ka referuar edhe tek vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.48, datë 14.10.1998, duke e përdorur atë si argument për pretendimet e tij. Kjo referencë nuk është me vend për rastin në shqyrtim. Në vendimin e sipërpërmendur të Gjykatës Kushtetuese, mungesa e legjitimitimit ishte e lidhur shprehimisht me përmbajtjen e një dispozite konkrete ligjore në kuptimin nëse një subjekt i caktuar publik legjitimohej të ngrinte ose jo padi në gjykatë.

Gjithashtu, nuk qëndron pretendimi i ngritur nga kërkuesi se gjykatat kanë vendosur tej objektit të padisë. Po t'i referohesh padisë, paditësi Vlash Marini ka kërkuar para gjykatës konstatimin e pavlefshmërisë së kontratave të shitjes së objektit e truallit dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Gjykata në vendimin e saj, duke pranuar kërkesën edhe për “kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme” i ka kthyer objektet e truallin Vlash Marinit e NEFINK-ut. Zgjdhja e çështjes nga gjykata është në përputhje me objektin e padisë.

Për të argumentuar kërkesën e tij, kërkuesi lidhur me tejkalimin e objektit të padisë, ka referuar tek vendimi nr.40, datë 30.9.1998 të Gjykatës Kushtetuese. Për rastin në shqyrtim, ky referim është pa vend. Vendimi i lartpërmendur bën fjalë për ndryshim të shkakut dhe objektit të padisë.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese nuk gjen shkak për të deklaruar antikushtetues e për të shfuqizuar vendimet përkatëse të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatës së Apelit Tiranë, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si dhe Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 gërma “f” të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Jemi për pranimin pjesërisht të kërkesës, e konkretisht për shpalljen antikushtetues e shfuqizimin e vendimit nr.H-31, datë 19.12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me këtë arsyetim:

Kërkuesi Hajredin Fratari si shkak të parë në kërkesën e tij, ka ngritur mungesën e legjitimitetit për Vlash Marinin në ngritjen e padisë, për pavlefshmëri të kontratës së shitjes. Mungesën e legjitimitetit kërkuesi e argumenton me “mungesën e interesit të ligjshëm” të Vlash Marinit për të ngritur padi, për arsye të mosekzistencës së ndërmarrjes së përbashkët, si dhe të bashkëpronësisë, duke parashtruar një sërë provash të cilat i ka paraqitur edhe para gjykatave.

Nga Gjykata Kushtetuese, parimisht, është pranuar se marrja në shqyrtim e një padie të bërë nga një subjekt që nuk legjitimohet, si dhe zhvillimi i gjykimit mbi këtë bazë, duke e pranuar atë si subjekt, i bën këto procese të parregullta në kuptimin kushtetues, e për rrjedhojë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese. Por, rasti konkret ka dallim rrënjësor nga rregulli i përgjithshëm. Nëse Vlash Marini legjitimohej ose jo, nëse ai ka pasur për çështjen interes, ky është një problem që lidhet pazgjydhshmërisht me zbatimin e ligjeve materiale, e konkretisht të dispozitave të Kodit Civil, të ligjeve mbi shoqëritë tregtare etj. Interpretimi e zbatimi i ligjeve materiale nuk është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese. Për pasojë, edhe shqyrtimi i shkakut të mësipërm për rastin konkret nuk është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese.

Jashtë kompetencës së Gjykatës Kushtetuese, është edhe kërkesa e dytë lidhur “me tejkalimin e objektit të padisë”.

Analiza e vendimeve, si dhe e kërkimeve të Vlash Marinit para gjykatave, vërteton se nga pikëpamja procedurale civile nuk ka “tejkalim” lidhur me “kthimin në gjendjen e mëparshme”, gjykatat kanë pranuar për aq sa ka kërkuar paditësi. Ndryshe qëndron çështja se ç’ka konsideruar gjykata “me gjendje të mëparshme” në kuptim të neneve 106-111 të Kodit Civil. Pikërisht, e shtruar çështja në këtë mënyrë, nëse janë zbatuar ose jo drejt dispozitat e mësipërme lidhur me restituimin, e bën gjykatën inkompetente për të shqyrtuar e dhënë vendimin për këtë çështje.

Pakica ka mendimin se vendimi nr.H-31, datë 19.12.2000 i Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duhej të shfuqizohej si antikushtetues. Nëpërmjet një gjykimi të parregullt, ky Kolegj i ka mohuar kërkuesit të drejtën që çështja e tij të shqyrtohej në një instancë gjykimi siç janë Kolegjet e Bashkuara. Ndërsa në rekurs, kërkuesi ka ngritur e ka argumentuar dy probleme ligjore, në përputhje me nenin 472 shkronja “a” të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Seleksionues, në vendimin e tij, është shprehur se “rekursi... nuk përmban shkaqe nga ato që parashikojnë nenet 472 e 473 të Kodit të Procedurës Civile...”.

Në këto kushte, vendimi i mësipërm duhej prishur dhe çështja i duhej dërguar Gjykatës së Lartë për shqyrtim.

Anëtar
A.Karamuç

Kryetar
F.Abdiu

V E N D I M Nr. 34, datë 15.5.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hajredin Fuga,	Anëtar i ““
Zija Vuci,	Anëtar i ““
Kristofor Peçi,	Anëtar i ““
Sokol Sadushi,	Anëtar i ““
Kujtim Puto,	Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 13.3.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.26 Akti që i përket:

K Ë R K U E S:

1. Esat Hasa, përfaqësues me prokurë i trashëgimtarëve të Baki Hasës.
2. Fadil Hasa, përfaqësues me prokurë i trashëgimtarëve të Xhemal Hasës. Të dy përfaqësues në gjykim nga avokati Kujtim Capo.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. Jeta Pustina, Kujtim Hasa, Fatmir Hasa, etj., trashëgimtarë të Abdulla Hasës, në mungesë.
2. Teuta Starova, trashëgimtare e Abdulla Hasës, e përfaqësuar nga avokati Dashamir Kore.
3. Seksioni i financës i Bashkisë së Durrësit, në mungesë.

O B J E K T I:

Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr.1000, datë 13.6.1997 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe nr.902, datë 23.6.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesit kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të këtyre vendimeve:

Të dy vendimet janë dhënë duke mos respektuar kërkesën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor sepse:

- Çështja është kaluar për gjykim në Kolegjin Civil pa qenë shkaqet e parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile për ankim me rekurs e për shqyrtimin në Kolegj. Në këtë mënyrë, Kolegji Civil ka tejkalluar kufijtë e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë.

- Kolegji Civil ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit, duke analizuar provat e administruara nga gjykatat e faktit. Për më tepër, është lënë në fuqi vendimi i gjykatës së rrethit, duke i ndryshuar në mënyrë tërësore mënyrën e arsyetimit. Në këtë mënyrë nuk është mbajtur parasysh ligji procedural për kufijtë midis shkallëve të gjykimit.

- Kolegji Civil ka prishur vendimin e gjykatës së apelit si “në kundërshtim me ligjin”, ndërsa Kolegjet e Bashkuara shprehen se Kolegji e ka prishur atë vendim me arsyetimin se “nuk është logjik”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin Kujtim Puto, shpjegimet e përfaqësuesve të kërkuesve, të subjektit të interesuar, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Durrës, në rigjykimin e çështjes civile me palë paditëse – kërkuesit Esat e Fadil Hasa, të paditur – subjektet e interesuar Jeta Pustina, Teuta Starova, Kujtim Hasa, me objekt njohje pronar mbi një sipërfaqe toke prej 50 dynym në favor të trashëgimtarëve të Baki Hasës dhe 38 dynym në favor të trashëgimtarëve të Xhemal Hasës, me vendimin nr.3294, datë 27.9.1996 ka vendosur rrëzimin e padisë.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.184, datë 17.1.1997, ka vendosur prishjen e këtij vendimi dhe, duke e gjykuar çështjen në fakt, ka detyruar të paditurit të njohin pronarë për 50 dynym tokë në fshatin Shkallnur Durrës, trashëgimtarët e Baki Hasës dhe për 40 dynym tokë, trashëgimtarët e Xhemal Hasës.

Kundër vendimit të gjykatës së apelit kanë bërë rekurs të paditurit në Kolegjin Civil të Gjykatës së Kasacionit, duke pretenduar se vendimi nuk është i bazuar në prova dhe është alogjik. Në këtë Kolegj çështja nuk është kaluar në dhomën e këshillimit, por në seancë.

Gjykata Kushtetuese konkludon se duke kaluar çështjen në seancë, Kolegji nuk ka zhvilluar proces jo të rregullt në kuptim të nenit 42/1 të Kushtetutës, siç pretendojnë kërkuesat. Në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile, përcaktohen shkaqet kur mund të ankimohen me rekurs vendimet e gjykatës së apelit, ndërsa sipas nenit 480 Kolegji vlerëson e vendos në dhomën e këshillimit mospranimin e rekursit kur mungojnë këto shkaqe. Jo vetëm kaq, por kalimi për gjykim në vetvete nuk përbën cenim të të drejtave kushtetuese të shtetasve dhe as proces jo të rregullt në kuptimin kushtetues, përderisa në gjykim u jepet më tepër mundësia palëve të argumentojnë shkaqet për të cilat vendimi, duhet të lihet në fuqi, të prishet ose të ndryshohet.

Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit me vendimin nr.1000, datë 13.6.1997, ka ndryshuar vendimin nr.184, datë 17.1.1997 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe ka lënë në fuqi vendimin nr.3294, datë 27.9.1996 të Gjykatës së Rrethit Durrës. Sipas nenit 485/a,b të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji ka të drejtë që për zgjidhjen e çështjes të mbajë atë qëndrim që mban njëra prej gjykatave të faktit: apelit ose rrethit, sipas vlerësimit që do t'i bëjë vetë. Nëse është i bazuar vendimi i çdo gjykate fakti dhe nëse interpretimi i ligjit, fakteve e rrethanave është alogjik, ky është vlerësim që bën vetë kolegji sipas kompetencave të veta dhe nuk ka të bëjë me procesin jo të rregullt në kuptimin kushtetues.

Për të argumentuar kërkesën e tyre, kërkuesat kanë referuar edhe tek vendimi nr.54, datë 21.11.1997 i Gjykatës Kushtetuese, në të cilin vendimi i Kolegjit Civil është vlerësuar si antikushtetues sepse ka analizuar provat ndryshe nga gjykata e shkallës së parë dhe ka vendosur vetë rrëzimin e padisë. Rasti nuk është analog. Në çështjen në shqyrtim, Kolegji ishte i detyruar të vlerësonte jo vetëm vendimin e gjykatës së rrethit, por edhe të apelit. Ky Kolegj, pasi arriti në përfundimin se vendimi i gjykatës së apelit, nuk ishte i bazuar, si dhe ishte alogjik e ka prishur këtë, dhe ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit, duke vepruar kështu në përputhje me kërkesat e nenit 485 të Kodit të Procedurës Civile.

Me vendimin nr.902, datë 23.6.2000, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që kanë shqyrtuar çështjen mbi rekursin në interes të ligjit, kanë lënë në fuqi vendimin e Kolegjit Civil të asaj gjykate. Me këtë vendim, Kolegjet e Bashkuara kanë pranuar se është në kompetencën e Kolegjit Civil të vlerësojë nëse është alogjik një vendim. Ato janë shprehur, gjithashtu, se sipas nenit 473 të Kodit të Procedurës Civile nuk kanë të drejtë të shqyrtojnë rekursin në interes të ligjit kur ka pretendime për mangësi në arsyetim apo për alogjizëm në një vendim gjyqësor të formës së prerë. Këto konkluzione janë të bazuara në Kodin e Procedurës Civile dhe Gjykata Kushtetuese edhe në këtë vendim nuk gjen elementet e një procesi jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42/1 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131, gërma “f” të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr. 40, datë 17.5.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapi,	Anëtar i ““
Zija Vuci,	Anëtar i ““
Hajredin Fuga,	Anëtar i ““
Alfred Karamuço,	Anëtar i ““
Kristofor Peçi,	Anëtar i ““
Kujtim Puto,	Anëtar i ““
Sokol Sadushi,	Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 30.4.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.41 Akti që i përket:

K Ë R K U E S E: Partia Republikane e Shqipërisë, përfaqësuar nga zotërinjtë Maksim Begeja, nënkryetar i Partisë dhe Arben Ristani, avokat.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në mungesë.
2. Komisioni i kufijve të zonave zgjedhore, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në mungesë.

O B J E K T I:

Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të ligjit nr.8746, datë 28.2.2001 “Për përcaktimin e zonave zgjedhore”.

Për shfuqizimin si antikushtetues të ligjit të sipërcituar, kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe kryesore:

- Ndarja e zonave zgjedhore është kryer në kundërshtim me nenin 64 pika 1 të Kushtetutës, që parashikon si kriter kryesor numërin e përafërt të zgjedhësve për çdo zonë;
- Në rreth 40% të zonave zgjedhore, Kuvendi ka lejuar devijime që tejkalojnë kufirin ligjor plus ose minus 5% të numrit mesatar të zgjedhësve, të parashikuar nga neni 71 i Kodit Zgjedhor.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesit e kërkuesit dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Pretendimin kryesor për të argumentuar antikushtetutshmërinë e ligjit nr.8746, datë 28.2.2001 “Për përcaktimin e zonave zgjedhore”, kërkuesi e bazon në mosrespektimin nga ligjvënësi të kriterit ligjor që ka parashikuar neni 71 pika 5 e Kodit Zgjedhor. Sipas kësaj dispozite, Komisioni i Kufijve të Zonave Zgjedhore “rishikon kufijtë e të gjitha zonave në mënyrë që diferenca mes numrit të zgjedhësve në çdo zonë dhe numrit mesatar të jetë, për aq sa është e mundur, brenda intervalit plus ose minus 5 për qind të numrit mesatar”.

Gjykata Kushtetuese çmon se ky pretendim i kërkuesit për shpalljen në tërësi të ligjit si antikushtetues nuk qëndron. Mosrespektimi i kriterit ligjor në kufijtë plus ose minus 5 për qind që duhet të ruhet ndërmjet numrit të zgjedhësve në çdo zonë dhe numrit mesatar, i parashikuar nga Kodi Zgjedhor, nuk është argument për të vërtetuar shkeljen apo moszbatimin e koncepteve dhe

parimeve kushtetuese në ligjin “Për përcaktimin e zonave zgjedhore”. Nëse midis ligjeve të ndryshme ka mospërputhje në tërësi apo në dispozita të veçanta, shqyrtimi i këtyre çështjeve nuk përfshihet në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, pasi, sipas nenit 131 shkronja “a” të Kushtetutës, ajo ka të drejtë të vendosë për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare.

Kërkuesi i është referuar gjithashtu edhe nenit 64 pika 1 të Kushtetutës, por pa analizuar dhe arsyetuar në kërkesë dhe në seancë gjyqësore shkeljet e konceptit kushtetues të numrit të përafërt të zgjedhësve.

Pavarësisht nga këndvështrimi apo mënyra që ka zgjedhur kërkuesi për të parashtruar argumentet për çështjen, objekt shqyrtimi, Gjykata Kushtetuese çmon se paraqitet e nevojshme t’i jepet një zgjidhje e plotë të gjitha pretendimeve të tij, duke e analizuar dhe interpretuar në aspektin kushtetues konceptin “numër të përafërt zgjedhësish”, të parashikuar në nenin 64 pika 1 të Kushtetutës.

Nga një interpretim literal i kësaj shprehjeje të krijohet përshtypja se Kushtetuta nuk ka vendosur korniza apo kritere strikte, por ka lejuar hapësirë për përcaktimin e zonave zgjedhore, pasi edhe sipas nenit 68 pika 2 të saj, rregullat e hollësishme për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, si dhe për ndarjen e zonave zgjedhore rregullohen me ligjin për zgjedhjet. Mbi këtë bazë është Kodi Zgjedhor që rregullon në mënyrë të veçantë të gjitha problemet që lidhen me zgjedhjet.

Koncepti kushtetues numër i përafërt zgjedhësish, nuk është i njëjlojtë dhe as nuk mund të konfondohej me numrin e barabartë të zgjedhësve, siç pretendon kërkuesi. Një koncept i tillë do të ishte i pakuptimtë për t’u përdorur në ndarjen e zonave zgjedhore, por edhe i pamundur njëkohësisht. Koncepti numër i përafërt zgjedhësish, sigurisht që e përmban në vetvete kriterin numerik, por nuk mund të konkludohet se ai është i vetmi kriter që shërben për përcaktimin e zonave zgjedhore.

Në Kushtetutë janë sanksionuar disa parime, kritere apo vlera të tjera kushtetuese, si tradita historike, nevojat e interesat e përbashkëta ekonomike, bashkëjetesa fetare, respektimi i pakicave kombëtare etj të cilat krahas shumë parimeve të tjera duhet të respektohen dhe të mbrohen nga shteti. Gjithashtu, janë të pranueshme dhe të nevojshme për t’u vlerësuar në këtë drejtim edhe kritere të tjera, si kompaktësia, kufijtë dhe barrierat natyrore, linjat e transportit dhe të komunikimit etj.

Koncepti “numër i përafërt zgjedhësish” është një kriter kushtetues që duhet ta kenë parasysh organet përkatëse kur propozojnë apo miratojnë ndarjen e zonave zgjedhore. Megjithatë, në aspektin e interpretimit gjuhësor, ky term përmban në vetvete edhe përjashtimin. Përderisa vetë Kushtetuta njih ndarjen e zonave me numër të përafërt zgjedhësish, ajo nënkupton se barazitizmi ndërmjet tyre bëhet objektivisht i pamundur, si dhe diferencimi në numër të pranueshëm zgjedhësish që mund të krijohet ndërmjet zonave në raport me numurin mesatar të zgjedhësve, është i lejueshëm dhe nuk mund të përbëjë shkak për antikushtetutshmëri. Kjo përafërsi në numër, sigurisht që duhet të përmbushet nga organi përkatës, por nëse nuk ka mundësi realizimi në praktikë, atëhere detyrimisht janë kriteret e tjera, të cilat jo vetëm që nuk duhet të cenohen, por duhet të ndërthuren njëkohësisht me njëri-tjetrin, për aq sa është e mundur për të patur një ndarje të drejtë të zonave zgjedhore.

Ky koncept kushtetues që duhet respektuar nga ligjvënësi në ndarjen e zonave zgjedhore, i analizuar nga ky këndvështrim, merr një kuptim edhe më të gjerë. Të kuptuarit e këtij koncepti kushtetues vetëm si kriter aritmetik, si dhe zbatimi i tij në mënyrën strikte numerike në ndarjen e zonave zgjedhore, sigurisht që mund të sjell edhe cënimin e parimeve apo vlerave të tjera kushtetuese. Pikërisht koncepti numër i përafërt zgjedhësish e merr kuptimin e drejtë vetëm pasi vlerësohet në kompleks me të gjitha parimet dhe kriteret e tjera kushtetuese.

Prandaj, marrja në konsideratë dhe vlerësimi në tërësinë e tyre për aq sa është e mundur, nga ana e Komisionit të Kufijve të Zonave Zgjedhore dhe të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë e këtyre kriterëve kushtetuese dhe ligjore, të cilat janë zbrëthyer më tej në nenin 71 të Kodit Zgjedhor, nuk përbëjnë shkelje të nenit 64 pika 1 të Kushtetutës dhe as devijim nga parimet dhe fryma që ajo përcjell për ndarjen e zonave zgjedhore.

Nga sa parashtruam më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se pretendimet e

kërkuesit për antikushtetutshmërinë e ligjit nr.8746, datë 28.2.2001 “Për përcaktimin e zonave zgjedhore”, nuk janë të bazuara në Kushtetutë dhe për rrjedhojë kërkesa e tij nuk duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 dhe 132 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Pakica ka mendimin se ligji nr.8746, datë 28.2.2001 “Për përcaktimin e zonave zgjedhore” vjen në kundërshtim me nenin 64 të Kushtetutës e për rrjedhim duhet të shfuqizohet. Ndërkohë, pakica ka mendimin se me qëllim që të mos pengohen zgjedhjet e caktuara për në datën 24 qershor 2001, vendimi për shfuqizimin e ligjit të mësipërm, bazuar në nenin 132 pika 2 e Kushtetutës, të hyjë në fuqi pas konstituimit të Kuvendit të ri.

Shkaqet për shfuqizimin si antikushtetues të ligjit nr.8746, datë 28.2.2001 i gjejmë:

- Në bazë të nenit 64 pika 1 e Kushtetutës “Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë. 100 deputetë zgjidhen drejtpërdrejt në zona njëmërore, me numër të përafërt zgjedhësish, 40 deputetë zgjidhen nga listat shumëmërore të partive dhe/ose të koalicioneve të partive, sipas renditjes në to”. Nga ana tjetër Kushtetuta në nenin 68 pika 2 parashikon rregullimin nga ligji për zgjedhjet i një sërë problemesh e midis tyre dhe përcaktimin e zonave zgjedhore.

Në zbatim të kësaj dispozite, Kodi Zgjedhor në një sërë dispozitash (nenet 67-75), trajton problemet që kanë të bëjnë me zonat zgjedhore njëmërore. Në nenin 71 të Kodit, janë përcaktuar një sërë kriteresh për caktimin e kufijve të zonave zgjedhore. Pikërisht detyra kryesore e Gjykatës Kushtetuese në shqyrtimin e kësaj çështjeje ishte që të vlerësonte se cilat kriterë kishin karakter kushtetues e duhej të zbatoheshin rigorozisht nga ligji. Pakica ka mendimin se Kushtetuta, përta i përket formimit të zonave zgjedhore, ka vetëm një kriter bazë, kriterin numerik. Ai është e mbetet kriter e s’mundet të zëvendësohet me kriterë të tjera të cilat mund të kenë rëndësinë e tyre, por kurrësesi jo atë kushtetuese.

Për Gjykatën Kushtetuese zgjidhja e problemit objekt shqyrtimi lidhet me interpretimin e zbatimit e këtij kriteri kushtetues e jo të kriterëve të tjera ligjore sepse do të ishte paradoks të shqyrtohej gjyqësisht përputhja e një ligji me kriteret e një ligji tjetër. Me të drejtë Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka refuzuar për shqyrtim një kërkesë të Partisë Republikane, lidhur me mosrespektimin e kriterëve të Kodit Zgjedhor në formimin e një zone zgjedhjeje me arsyetimin se ato janë kriterë ligjore e për pasojë Gjykata Kushtetuese nuk ka si të shqyrtojë përputhjen e ligjit me ligjin (vendimi nr.32, datë 08.5.2001).

Duke u bazuar në nenin 64 pika 1 të Kushtetutës, Kodi Zgjedhor bën interpretimin e kriterit bazë “numër të përafërt zgjedhësish” nga ku përcakton që diferenca mes numrit të zgjedhësve në çdo zonë dhe numrit mesatar të jetë “për aq sa është e mundur, brenda intervalit plus ose minus 5 % të numrit mesatar”.

Është detyrë parësore e një shteti demokratik që, për të realizuar zgjedhje sa më demokratike, t’u krijojë mundësi të barabarta qytetarëve për të zgjedhur e për t’u zgjedhur. Në këtë drejtim rolin e vet luan edhe ndarja racionale e zonave të zgjedhjeve. Do të ishte absurditet të pretendohet për ndarje ideale, me numër të barabartë, prandaj ideja e Kushtetutës për numër të përafërt zgjedhësish si kriter bazë në ndarjen e zonave është rezultat i një arsyetimi e analize

normale. Po aq i arsyeshëm e i pranueshëm është për ne interpretimi që i bën këtij problemi Kodi Zgjedhor, duke vënë “atje ku është e mundur” kufijtë plus numër 5 %. Edhe sikur ky kriter kushtetues nuk do të ishte zbrërthyer nga ligji, i takon Gjykatës Kushtetuese që për të arritur në përfundime të drejta, të bënte ajo interpretimin.

Parë në këtë këndvështrim, ligji për ndarjen e zonave të zgjedhjeve, ka dalë jashtë frymës dhe përmbajtjes së Kushtetutës. Për çfarë zbatimi të Kushtetutës mund të bëhet fjalë kur në 50 zona zgjedhore (gjysma e të gjithëve) ka kapërcim të limiteve (mbi ose nën 5 %); për çfarë “numër të përafërt” mund të bëhet fjalë kur në 16 zona diferenca është mbi ose nën 10 % të mesatares të zgjedhësve (zonat 5, 9, 13, 20, 21, 33, 47, 51, 60, 61, 63, 66, 73, 75, 84, 90); kur në tre zona diferenca shkon në mbi ose nën 15 % ose kur diferenca midis zonës më të madhe e asaj më të vogël në ligj është 33,48 % e zgjedhësve (zonat 9, 63).

Këto të dhëna, të cilat nuk kanë nevojë për koment, tregojnë në mënyrë të plotë se në ligjin nr.8746, datë 28.2.2001 “Për përcaktimin e zonave zgjedhore”, është shkelur haptazi kriteri bazë kushtetues i ndarjes së zonave mbi bazën e “numrit të përafërt të zgjedhësve”.

Në vendimin e saj, shumica ruan mendimin se në krijimin e zonave, krahas kriterit numerik, duhej të kihen parasysh edhe kriteret e tjera të parashikuara në Kodin Zgjedhor (pika 8 e nenit 71). Pa përsëritur argumentin sipas të cilit Gjykata Kushtetuese nuk merret me përputhjen e ligjit me ligjet, duhet theksuar se edhe pakica ka mendimin se kriteret e ligjit duhen marrë parasysh, por deri sa ato të mos cenojnë kriterin kushtetues. Me tablonë e shifrave që u paraqitën është zor të mendohet që për hir të këtyre kriterëve të mënjanohet (e për më tepër të denatyrohet) kriteri bazë kushtetues në formimin e zonave të zgjedhjeve.

ANËTAR
A.Karamuço

V E N D I M
Nr. 41, datë 17.5.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hajredin Fuga,	Anëtar i ““
Zija Vuci,	Anëtar i ““
Alfred Karamuço,	Anëtar i ““
Sokol Sadushi,	Anëtar i ““
Kujtim Puto,	Anëtar i ““
Kristofor Peçi,	Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 13.03.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.26 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: Gaspër Elezaj, i përfaqësuar nga avokati Ali Metaj, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:Këshilli i Lartë i Drejtësisë, i përfaqësuar nga inspektori Alfred Progonati, me autorizim.

O B J E K T I:

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.70, datë 12.2.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr.1348, datë 1.11.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Për shfuqizimin si antikushtetues të këtyre vendimeve, kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

1. Shkeljet e konstatuara në gjykimin e çështjeve penale e civile nuk janë të tilla që të trajtohen si akte apo sjellje që diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit dhe autoritetin e drejtësisë, siç është përcaktuar në nenin 147 pika 6 të Kushtetutës dhe neneve 40 e 42 të ligjit “Për organizimin e

pushtetit gjyqësor”. Ato janë të lidhura me punën e ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”. Ato janë të lidhura me punën e përditshme të çdo gjyqtari.

2. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, si organ administrativ, duhej të zbatonte vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe të merrte një masë tjetër disiplinore përveç shkarkimit nga detyra. Ai ka vepruar në kundërshtim me nenin 44/1 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998, pasi si organ i paanshëm që shqyrton kërkesën për procedim disiplinor, nuk duhet ta kërkojë vetë apo ta vërë në lëvizje këtë procedim.

3. Zvarritjet në gjykim kanë ndodhur për organizim të punës për të cilin është vënë në dijeni kryetari i gjykatës.

4. Kolegjet e Bashkuara e gjykan çështjen në datën 1.11.2000, por nuk e shpallën vendimin.

5. Arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë, vjen në kundërshtim me provat e shqyrtuara në seancë gjyqësore, me relacionet e Inspektoratit e kërkesat për procedim disiplinor, por edhe me vetë vendimin e mëparshëm të saj.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoji relatorin Kristofor Peçi, kërkuenin dhe përfaqësuesin e tij, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili është lënë në fuqi nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kërkueni Gaspër Elezi, është shkarkuar nga detyra e gjyqtarit të shkallës së parë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër me motivacionin “për zvarritje të rënda dhe sistematike në kryerjen e detyrës, për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, si dhe për moskryerje të veprimeve të detyrueshme procedurale”.

Në kundërshtim me sa ka parashtruar kërkueni në kërkesën e tij, Gjykata Kushtetuese çmon se nuk ndodhemi para një procesi të parregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

Kërkueni, duke argumentuar se shkeljet nuk janë të tilla që të trajtohen si akte apo sjellje që diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit dhe autoritetin e drejtësisë, siç kërkon neni 147/6 i Kushtetutës, pranon shkeljet e kryera prej tij. Përsa i përket vlerësimit të tyre, karakterit të rëndë apo diskreditues, shkallës së përgjegjësisë etj., këto janë bërë nga organet që kanë gjykuar çështjen, si Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat kanë vendosur sipas kompetencave. Përderisa kërkueni nuk i ka kontestuar shkeljet dhe nuk ka parashtruar argumente për proces të parregullt, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, nuk i takon Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë shkeljet për masën e marrë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Pretendimi se Këshilli i Lartë i Drejtësisë ishte i detyruar të zbatonte vendimin e Kolegjeve të Bashkuara për të marrë një masë tjetër disiplinore veç shkarkimit nga detyra dhe se ai ka vënë në lëvizje procedimin disiplinor ndaj kërkuenit, nuk qëndron. Nga aktet rezulton se me shkresën nr.3160/1, datë 15.9.1999 të Ministrisë të Drejtësisë është kërkuar verifikimi i të dhënave para fillimit të procedimit disiplinor për kërkuenin dhe se masa e shkarkimit nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë është marrë pas këtij verifikimi, duke u njohur në kohë kërkueni me rezultatet e kontrollit.

Përsa i përket pretendimit për mosshpallje të vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, edhe nëse është i vërtetë, për rastin konkret nuk ka ndikuar në zgjidhjen e çështjes.

Në këto kushte meqënëse kërkueni nuk parashtron argumente për proces të parregullt ligjor, kërkesa e tij duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 gërma “f” të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Kërkesa e gjyqtarit Gaspër Elezaj duhet të ishte pranuar për këto shkaqe:

1. Formulimi i pikës 6 të nenit 147 të Kushtetutës garanton parimin e patundshmërisë së gjyqtarit. Duke përcaktuar në mënyrë të qartë e të plotë rastet kur gjyqtari mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Kushtetuta nuk lejon që shkarkimi të bëhet edhe për raste të tjera të parashikuara nga ligje të veçanta. Për këto raste të fundit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të marrë masa të tjera disiplinore të shkallës më të ulët, por jo shkarkim nga detyra. Në vendimin nr.70, datë 12.2.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr.1348, datë 1.11.200 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, thuhet se shkarkohet nga detyra gjyqtari Gaspër Elezaj me motivacionin: “për zvarritje të rënda dhe sistematike në kryerjen e detyrës, për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e detyrës, si dhe për moskryerje të veprimeve të detyrueshme procedurale”.

Ky motivacion, i cili përbën edhe shkakun e largimit nga detyra, është krejtësisht i ndryshëm nga kriteret e përcaktuara në nenin 147/6 të Kushtetutës. Termat e Kushtetutës “për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit” ose “pamjaftueshmëri profesionale”, që mund të përlligjin marrjen e kësaj mase ekstreme, as që janë përmendur fare në vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kur këto vendime duhet të ishin arsyetuar pikërisht mbi këtë bazë.

Këtë qëndrim ka mbajtur Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.29, datë 30.4.2001 që i përket kërkesës së gjyqtarit Ardian Kalia. Duke analizuar se Këshilli i Lartë i Drejtësisë në përzgjedhjen e masës disiplinore nuk ka patur sa duhet parasysh edhe kërkesat e nenit 147 pika 6 të Kushtetutës, në vendim përmendet se zbatimi i kësaj dispozite kushtetuese është lidhur vetëm me kryerjen e akteve që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Në vazhdim, ky vendim konstaton se Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk kanë argumentuar se cilat janë shkaqet e vërteta të shkeljeve që i atribuohen kërkuarit, nëse ato janë rezultat i veprimeve me dashje që diskreditojnë pozitën e tij si gjyqtar apo janë gabime të zakonshme që mund të kenë ardhur nga mungesa e përvojës së tij në këtë detyrë.

2. Vlerësimi i vendimeve të gjykatës nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe mbi këtë bazë marja e masës disiplinore ndaj gjyqtarit është veprim antikushtetues. Për vendimet e gjykatave mund të vendosë vetëm gjykata më e lartë dhe asnjë organ tjetër. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ndonëse është një organ i ngarkuar nga Kushtetuta për të marrë masa disiplinore ndaj gjyqtarëve deri në shkarkimin e tyre, duke mos qenë instancë më e lartë gjyqësore, nuk ka kompetencë as të cenojë dhe as të vlerësojë përmbajtjen e vendimeve të gjykatave. Pasojat negative të një veprimi të tillë antikushtetues do të dukeshin qartë në rast se këto veprime të vlerësuara të padrejta nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe që pasohen me shkarkimin nga detyra të gjyqtarit, do të konsideroheshin të bazuara nga instancat më të larta gjyqësore.

Në rrethana të njëjta, Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.29, datë 30.4.2001, ndër të tjera, shprehet: “vendimet gjyqësore të formës së prerë, për çështjen konkrete që zgjidhin, kanë fuqinë e ligjit. Kjo do të thotë që për sa kohë ato nuk janë prishur ose ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër shtetëror nuk mund të mos përfillë përmbajtjen e tyre dhe të ngarkojë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes”.

Përderisa edhe në rastin e kërkuarit Gaspër Elezaj, kemi të bëjmë me vlerësime të vendimeve nga një organ tjetër dhe jo nga Gjykata, duhet të ishte mbajtur i njëjti qëndrim si në vendimin e sipërcituar të Gjykatës Kushtetuese për pranimin e kërkesës.

Anëtar Anëtar
K.Peçi Z.Vuci

NDREQJE GABIMI

Në Fletoren Zyrtare nr.24, viti 2001, në ligjin nr.8781, datë 3.5.2001 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë””, në faqen 760, në nenin 18, numri “69” bëhet “60”; në nenin 19 , në rreshtin e nëntë, fjala “të shoqatës” bëhet “të fondacionit”.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 28.5.2001
Doli nga shtypi më 30.5.2001

Tirazhi: 4100 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2001

Çmimi: 200 lekë